

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Rajmonda Kotorri që u zhduk 16 vjeçe në Itali është gjetur?

Shkruar nga: S. H | Publikuar më: 27.09.2026, 10:29



Share



Share



Rajmonda Kotorri, e cila u largua drejt Italisë kur ishte vetëm 16 vjeçe dhe humbi kontaktet me familjen për vite me radhë, dyshohet se mund të jetë pikasur në Milano. Lajmi është bërë i ditur nga emisioni italian "Chi l'ha visto?", pasi një shikues i ka dërguar redaksisë një fotografi të një gruaje që ngjason me Rajmondën.

Familja e saj nuk ka reshtur së kërkuari për vite me radhë, ndërsa apeli për gjetjen e Rajmondës është publikuar edhe në emisionin italian. Motrat e saj kanë parë fotografinë dhe shprehen se gruaja e fotografuar ka ngjashmëri të madhe me nënën e tyre kur ishte e re. Për familjarët, kjo është një gjurmë që ka rikthyer shpresën për të mësuar se çfarë ka ndodhur me Rajmondën.

Tashmë pritet verifikimi i identitetit të gruas së fotografuar në Milano. Familja shpreson që kjo të jetë pista që do t'i çojë pas kaq shumë vitesh drejt gjetjes së Rajmondës dhe ribashkimit me të.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.